



## **VENDIM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE**

**Data e miratimit: 26 nëntor 2013**

**Numri i lëndës: 2011-07**

**W.**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 25 dhe 26 nëntor 2013, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar  
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore  
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. VENDIMI I PANELIT I DATËS 10 PRILL 2013**

1. Më 10 prill 2013, Paneli ka miratuar vendimin e mëposhtëm dhe ka bërë një numër rekomandimesh në lidhje me ankesën e W:

“Paneli njëzëri:

1. *Konstaton* se nuk ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës [Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore];
2. *Konstaton* se ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës;
3. *Gjen* të përshtatshme, në bazë të gjetjeve të mësipërme të fakteve dhe ligjit, të bëjë rekomandime për ShM (Shefin e Misionit) sipas rregullës 34 të rregullores së punës, dhe
4. *Rekomandon* që të ndërmerren nga ShM veprimet e dhëna më poshtë:
  - Duhet të bëhet një deklaratë me të cilën pranohet se rrethanat e rastit përbëjnë shkelje të të drejtave të ankuesit që i ngarkohen veprimeve të EULEX-it gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv;
  - ShM duhet të urdhëroj që të miratohen pa vonesë masat e paraqitura në vijim:
    1. Prokurorët e EULEX-it të ngarkuar me këtë lëndë duhet të ftohen që të kërkojnë nga homologët e tyre serb që t’iu kthejnë kopjet e secilit dokument që iu është ofruar atyre, e që mbajnë emrin apo i referohen parashtruesit të ankesës. Kjo përfshinë të dy deklaratat që parashtruesi i ankesës i ka dhënë EULEX-it.
    2. Prokurorët e EULEX-it të ngarkuar me rastin duhet të ftohen që të kërkojnë prej homologëve të tyre serbë:
      - i. Të asgjësojnë secilën kopje të bërë nga dokumentet e lartpërmendura dhe ta fshijnë emrin dhe secilën informatë në dokumentet e tjera që mund të identifikoj parashtruesin e ankesës; dhe
      - ii. Të njoftoj prokurorët e EULEX-it se kjo gjë është kryer; dhe
      - iii. Mos t’i zbulohet ndonjë të dyshuari apo të pandehuri asnjë informatë që parashtruesi i ankesës i kishte ofruar EULEX-it.
    - ShM duhet të urdhëroj një vlerësim se cilat instrumente ligjore janë në dispozicion të prokurorëve të EULEX-it për të bashkëpunuar rreth çështjeve gjyqësore dhe penale dhe të ndërmerren hapa të nevojshëm në përpjekje për t’i vënë në fuqi të gjitha instrumentet ligjore të nevojshme nëse përcaktohet se baza ligjore në dispozicion është jo e përshtatshme dhe e pamjaftueshme;
    - Në pritje të këtij vlerësimi, ShM duhet të udhëzoj prokurorët e EULEX-it që të mos bartin ndonjë informacion të ofruar nga dëshmitarët tek autoritetet (serbe apo ndonjë tjetër) pa marrë ndonjë siguri nga organet kompetente hetuese dhe prokuroriale të EULEX-it se ka bazë të mjaftueshme ligjore për atë qëllim dhe se prokurorët e EULEX-it do të veprojnë në pajtim me këto kërkesa ligjore në të gjitha rrethanat;
    - ShM duhet të urdhëroj organet kompetente të EULEX-it që të zhvillojnë një vlerësim të plotë të rrezikut ndaj parashtruesit të ankesës dhe/ose familjes së tij, si pasojë e dhënies së deklaratave të tij tek autoritetet serbe. Pasi kjo të bëhet dhe nëse identifikohet ndonjë rrezik, Paneli rekomandon që EULEX-i duhet të diskutoj me parashtruesin e ankesës

rreth çfarëdo hapi apo mase që mund të merret për të kufizuar dhe për të parandaluar rrezikun e dëmit.

- ShM ftohet që të shpërndaj këtë vendim tek zyrtarët përkatës të EULEX-it, të përfshirë në hetimin dhe ndjekjen e krimeve në Kosovë, me qëllim që të sigurohet se ata vetëdijesuar për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre karshi dëshmitarëve, nga të cilët marrin informacione.”

2. Vendimi i tanishëm përbën një vazhdimësi të vendimit të Panelit të datës 10 prill 2013 dhe rekomandimeve të bëra në të. Kompetenca dhe autoriteti i Panelit për t'i përcjellë vendimet dhe rekomandimet e veta është paraparë në rregullën 45 *bis* të rregullores së punës së Panelit (shih *p.sh.* vendimet për zbatimin e rekomandimeve 2010-01 [Dijeljalj Kazagic kundër EULEX-it](#), 23 nëntor 2011 dhe 2010-07, [Blerim Rudi kundër EULEX-it](#), 23 nëntor 2011).

## II. INFORMATA NGA ShM i EULEX-it

3. Më 30 maj 2013, Shefi i Misionit (ShM) ka njoftuar Panelin për një sërë masash të cilat ai ka synuar t'i ndërmerr në lidhje me rekomandimet e Panelit. Në veçanti, ai ka treguar se i kishte dërguar komunikimet tek shefi i divizionit ekzekutiv të EULEX-it dhe tek kryeprokurori i EULEX-it (KPE), duke i informuar ata për vendimin e Panelit dhe duke kërkuar prej tyre që të ndërmarrin për aq sa është e mundur veprimet e duhura në mënyrë që të zbatoheshin masat e rekomanduara.
4. Më 16 gusht 2013, ShM ka njoftuar Panelin rreth veprimeve të mëtejshme të ndërmarra për zbatimin e vendimit dhe rekomandimeve të Panelit.
5. Në lidhje me rekomandimin se prokurorët e EULEX-it të ngarkuar me rastin duhet të ftohen që të kërkojnë prej homologëve të tyre serbë t'i kthejnë, asgjësojnë apo fshijnë kopjet e secilit dokument që bartin të dhëna, të cilat mund të identifikojë ankuesin, ShM ka propozuar se një veprim i tillë do të ishte i dëmshme për bashkëpunimin në hetimet penale midis EULEX-it dhe Serbisë. Për më tepër, ai ka pohuar se kërkesa për të zbatuar masat e mësipërme do të shkonte kundër "pozicionit autonom" të prokurorëve të EULEX-it.
6. ShM-ja më tej ka përmendur rekomandimin e Panelit për të bërë një vlerësim të instrumenteve ligjore rreth bashkëpunimit në çështjet e bashkëpunimit gjyqësor dhe penal dhe nëse është e nevojshme të ndërmerren hapa që të këto instrumente të tilla të hyjnë në fuqi. ShM konsideron se instrumentet e duhura ligjore tashmë janë në fuqi dhe janë duke u zbatuar në mënyrë të duhur. Ai posaçërisht iu drejtua nenit 88 të ligjit nr. 04/L-031 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale, i cili ka hyrë në fuqi pas ngjarjeve për të cilat ka pasur ankesë në rastin në fjalë. Neni përkatës thotë:

## Neni 88

### Shkëmbimi i informatave

Pa cenuar zhvillimin e hetimeve ose procedurës penale, organi kompetent gjyqësor në Kosovë mundet që pa kërkesë paraprake t'ia përcjell organit kompetent të shtetit të huaj informatat e siguruara në kuadër të hetimeve të tyre, nëse konsiderojnë se zbulimi i informatave të tilla mund t'i ndihmojë shtetit pranues të nis apo merr përsipër hetimet ose procedurat penale, ose mund të shpie në një lutje për ndihmë juridike të ndërsjellë parashtruar nga shteti pranues.

7. Sa i përket rekomandimit për vlerësimin e rrezikut ndaj ankuesit dhe/ose familjes së tij si rezultat i deklaratës së tij që ju ishte ofruar autoriteteve serbe, Paneli thekson se në vendimin e tij rreth meritave të lëndës ka gjetur se autoritetet ndjekëse të EULEX-it nuk kishin zhvilluar vlerësimin e nevojshëm të rrezikut në mënyrë që të përcaktohej se çfarë masash mund të jenë të domosdoshme në ato rrethana për të garantuar sigurinë e parashtruesit të ankesës dhe të familjes së tij (shih vendimin e pranueshmërisë, të cituar më sipër, par. 52).
8. Në këtë kuptim, ShM është mbështetur në mendimin e dhënë nga kryeprokurori i EULEX-it (KPE). Ai ka pohuar se sipas KPE, para se t'u ofronte autoriteteve serbe deklaratën e ankuesit, prokurori i EULEX-it e kishte konsideruar vendndodhjen e të dyshuarve (në atë kohë ata ishin në Serbi), mungesën e çfarëdo mundësie të arrestimit dhe ndjekjes së tyre në Kosovë dhe gatishmërisë së autoriteteve serbe për të marrë përsipër hetimin. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë informatë apo informatë të fshehtë që ka treguar rreth ndonjë rreziku ndaj ankuesit. E gjithë kjo ka çuar në vendimin për të dorëzuar deklaratën e ankuesit tek autoritetet serbe. Po ashtu KPE e kishte siguruar ShM se nuk ishte i nevojshëm ndonjë vlerësim tjetër i rrezikut. ShM më tej ka theksuar se pasi që ishte publikuar vendimi i Panelit, ankuesi ishte paraqitur në TV, ishte identifikuar me emrin e tij, ku kishte komentuar veprimet e EULEX-it.
9. Në përgjigjen e vet ShM nuk ka përmendur rekomandimin e Panelit për të pranuar shkeljen e të drejtave të ankuesit dhe për të shpërndarë vendimin e Panelit tek stafi përkatës.
10. Më 30 gusht 2013, Paneli i ka dërguar një letër ShM, duke përsëritur rëndësinë e shpërndarjes së vendimit të vet. Paneli ka theksuar se ajo ishte e domosdoshme për të kuptuar në mënyrë të plotë dhe të duhur çështjet e të drejtave të njeriut që ndikojnë në punën dhe rezultatit e stafit të EULEX-it në fushën e së drejtës penale, përfshirë ndjekjen penale të krimeve të dyshuara të luftës. Gjithashtu ajo ka kontribuar në përpjekjen më të gjerë të EULEX-it për të siguruar llogaridhënie për të drejtat e njeriut dhe respektim të sundimit të ligjit.
11. Në përgjigjen e tij të datës 3 shtator 2013, ShM ka njoftuar Panelin se ai kishte miratuar masat e nevojshme për të siguruar shpërndarjen e

vendimit tek zyrtarët e EULEX-it dhe njësitë e përfshira në hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve.

### **III. INFORMATA NGA ANKUESI**

12. Më 27 shtator 2013, ankuesi ka vizituar zyrën e Panelit dhe ka dhënë një deklaratë me gojë, duke komentuar veprimet e ShM.
13. Ai nuk është pajtuar me propozimin e ShM se një vlerësim i rrezikut ndaj ankuesit dhe/ose familjes së tij ishte i panevojshme. Ai gjithashtu ka pohuar se kishte kërkuar vazhdimisht nga EULEX-i që të ketë mbrojtje si dëshmitar, pasi i frikësohej hakmarrjes nga personat për të cilët ai kishte ofruar informata.
14. Në lidhje me paraqitjen e tij në media, ai ka pohuar se ishte kontaktuar nga ta dhe se kishin bërë pyetje të përgjithshme në lidhje me drejtësinë në Kosovë dhe ai nuk e kishte diskutuar lëndën e tij me ta.
15. Ai më tej shprehu zhgënjimin e tij se EULEX-i nuk i kishte kërkuar ndjesë lidhur me këtë çështje.

### **IV. VLERËSIMI NGA PANELI**

16. Paneli konstaton dhe lavdëron hapat e ndërmarra nga ShM për të zbatuar një numër të konsiderueshëm të rekomandimeve të tij. Megjithatë Paneli konsideron se nuk janë zbatuar rekomandime të caktuara.
17. Në veçanti, ShM ka zgjedhur që mos të bëjë ndonjë deklaratë që pranon se rrethanat e rastit kanë përbërë shkelje të të drejtave të ankuesit që i ngarkohen veprimeve të EULEX-it. Duke marrë parasysh rëndësinë e shkeljes së të drejtave të ankuesit dhe në veçanti mjetet e kufizuara të dëmshpërblimit në dispozicion në këtë lëndë, një vendim i tillë është për të ardhur keq. Prandaj, Paneli fton ShM të konsideroj që zyrtarisht të pranoj shkeljen e të drejtave të ankuesit dhe në këtë drejtim të njoftoj ankuesin rreth pozitës së tij.
18. Më tej, vihet re se rekomandimi që prokurorët e EULEX-it duhet të kërkojnë nga homologët e tyre serbë që t'i kthejnë apo asgjësojnë kopjet e dokumenteve të cilat bartin emrin e ankuesit dhe të fshijnë secilin informatë në dokumentet e tjera që mund të identifikojnë atë nuk është zbatuar. Si arsytim për mos zbatimin e këtij rekomandimi, ShM mbështetet në një sugjerim se një kërkesë e tillë do të ndikonte negativisht në bashkëpunimin në hetimet penale midis EULEX-it dhe Serbisë. Paneli konstaton se një bashkëpunim i tillë është padyshim në interes të luftimit efektiv kundër krimeve të luftës. Megjithatë, në

një rast të tillë ku mund të preken të drejtat themelore të dëshmitarit ose të të akuzuarit, kërkohet që autoritetet kompetente të sigurojnë se do të ketë ekuilibër të drejtë midis atyre të drejtave dhe interesit legjitim publik në ndjekjen e krimeve të tilla.

19. Paneli nuk mund të pajtohet në rastin në fjalë se rekomandimi i vet do të ketë efekt të dëmshëm gjoja ndaj bashkëpunimit. E as nuk është konstatuar për ta bindur Panelin se ka pasur ndonjë ekuilibër të drejtë midis interesave të prokurorëve dhe atyre të ankuesit kështu që të drejtat e këtij të fundit nuk mund të thuhet se kanë qenë të kufizuara vetëm në masën e nevojshme dhe proporcionale sipas rrethanave (shih vendimin e tij *W kundër EULEX-it* të 10 prillit 2013, par. 45). Përkundrazi, hapi i rekomanduar nga Paneli thekson rëndësinë për partnerët bashkëpunues që t'ju përgjigjen kërkesave të arsyeshme të dëshmitarëve që frikësohen për sigurinë e vet. Thelbi i tij kufizohet në sigurimin e vëmendjes së duhur ndaj ofrimit të sigurisë dhe mbrojtjes së dëshmitarëve gjatë hetimeve penale, kur rrethanat e rasteve që janë nën hetim e sipër tregojnë se mund të ngritën probleme në këtë drejtim.
20. Gjithashtu ShM mbështetet në sugjerimin e KPE se zbatimi i një kërkesë të tillë mund të bie ndesh me “pozicionin autonom” të prokurorit. Kjo konsiderohet të jetë jomeritore. Autonomia e dhënë autoriteteve të ndjekjes për të kryer funksionet e tyre nuk mund të interpretohet si leje për të vepruar pa konsideratë të duhur ndaj masave mbrojtëse procedurale dhe standardeve përkatëse të të drejtave të njeriut të atyre që kanë të bëjnë me procesin ligjor apo gjyqësor (shih komisionin ndërkombëtar të *parimeve ndërkombëtare të juristëve rreth pavarësisë dhe përgjegjësisë së gjyqtarëve, avokatëve dhe prokurorëve - Udhërrëfyes për praktikuesit nr. 1*). Prokurorët e EULEX-it janë pjesë e misionit dhe si të tillë i nënshtrohen standardeve përkatëse të të drejtat të njeriut dhe masave mbrojtëse, të cilat janë në fuqi për të garantuar mbrojtjen efektive të këtyre të drejtave. Në këtë kuptim, asnjë pretendim për “autonomi” nuk mund t'i arsyetoj veprimet e ndërmarra nga prokuroria gjatë shkëljes së këtyre standardeve. Shih p.sh. Udhëzimet e KB-së mbi rolin e prokurorëve, të miratuar nga kongresi i tetë i Kombeve të Bashkuara për parandalimin e krimit dhe trajtimin e të pandehurve, Havanë, Kubë, 27 gusht - 7 shtator 1990 par. 12 (“Në përputhje me ligjin prokurorët duhet të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të drejtë, vazhdimisht dhe shpejt, dhe të respektojnë e mbrojnë dinjitetin njerëzor dhe të përkrahin të drejtat e njeriut, duke kontribuar kështu në sigurimin e procesit të duhur dhe funksionimit të qetë të sistemit të drejtësisë penale”).
21. Duke pasur parasysh çfarë u tha më lartë, Paneli rekomandon që ShM duhet të konsideroj përsëri zbatimin e rekomandimit nr. 2 të vendimit fillestar të Panelit. Posaçërisht nëse autoritetet serbe kanë vendosur që mos të kërkojnë nga ankuesi të dëshmon, duket se ka pak arsye për rimarrjen e atyre informatave, të cilat nëse zbulohen me gjasë mund të rezultojnë me dëm të madh për ankuesin.

22. Paneli vënë re se në fuqi ka hyrë një ligj i ri për bashkëpunim ndërkombëtar në çështje penale që prej ngjarjeve rreth të cilave është bërë ankesa. Paneli vëren më tej se, në zbatim të këtij ligji EULEX-i duhet të siguroj se ky ligj është duke u interpretuar dhe zbatuar nga agjentët e tij në mënyrën e cila është në përputhje me të drejtat themelore të atyre që janë të prekur.
23. Paneli vëren me shqetësim se vlerësimi i rrezikut rekomanduar nga Paneli nuk është zbatuar. Për të arsyetuar mosveprimin e Misionit, ShM është mbështetur në bindjen e KPE se “nuk është i nevojshëm ndonjë vlerësim tjetër i rrezikut”. Panelit nuk ju është ofruar dëshmi se fillimisht është kryer ndonjë vlerësim efektiv i rrezikut. Në të vërtetë, kjo e gjetur ka qenë baza e vendimit të vet se të drejtat e ankuesit të garantuara sipas nenit 8 të Konventës ishin shkelur. Paneli nuk mund ta shoh se si mund të arsyetohet përfundimi se nuk ekziston ndonjë rrezik dhe se nuk është i nevojshëm ndonjë vlerësim “tjetër” i rrezikut.
24. Në ato rrethana, Paneli mbetet i shqetësuar se EULEX-i nuk ka zhvilluar ndonjë vlerësim të mjaftueshëm të rrezikut që i kanoset ankuesit dhe familjes së tij, pavarësisht prej rekomandimit të Panelit në këtë drejtim. Prandaj, Paneli fton ShM të merr parasysht që të udhëzoj autoritetet kompetente për të kryer një vlerësim të plotë të kësaj çështje. Më tej, Paneli rekomandon që ShM duhet të kërkoj udhëzime të nevojshme nga organet e EULEX-it, të cilat në mënyrë të veçantë janë të ngarkuar me përgjegjësinë e mbrojtjes së dëshmitarëve në rastet e ndjeshme penale.
25. Në lidhje me rekomandimin e Panelit që të shpërndahet vendimi i vet tek zyrtarët përkatës të EULEX-it të përfshirë në hetimin dhe ndjekjen e krimeve në Kosovë, Paneli me kënaqësi vë në pah sigurimin nga ana e ShM se ky rekomandim është zbatuar siç duhej.
26. Pas shqyrtimit të informacionit të dhënë nga palët në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Panelit,

## **PANELI NJËZËRI**

*Deklaron se ShM ka zbatuar rekomandimet e tij në këtë rast vetëm pjesërisht,*

*Vendos të ftojë ShM që edhe njëherë të merr parasysht zbatimin e rekomandimeve të Panelit në bazë të këtij vendimi duke nxjerrë udhëzimet e nevojshme dhe të njoftoj Panelin siç duhet jo më larg se me datën 30 dhjetor 2013.*

*Rekomandon që ShM duhet të siguroj shpërndarjen e plotë të këtij vendimi tek zyrtarët përkatës të EULEX-it të përfshirë në hetimin dhe ndjekjen e krimeve në Kosovë.*

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese